

Datë 30 / 10 / 2023

NGA: “Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë”
(NAREA)

DREJTUAR: Mediave të shkruara dhe audiovizive

LËNDA: Deklaratë për shtyp mbi daljen e Shqipërisë nga **Lista e Vendeve me Monitorim të Shtuar të FATF/MoneyVal** (Lista Gri e Parandalimit të Pastrimit të Parave)

Të nderuar kolegë,

Na lejoni të ndajmë se për **NAREA** “Shqipëria jashtë Listës Gri të FATF/MoneyVal” – është lajm inkurajues jo vetëm për Ekzekutivin shqiptar por njëlloj edhe për Sipërmarrjen, sidomos ata që janë motor të ekonomisë tonë, siç është sektori i Real Estate.

NAREA, brenda një periudhe të shkurtër që nga krijimi, ka arritur që të jetë poli përfaqësues i sektorit të Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme (Real Estate), duke kontribuar në mënyrë aktive jo vetëm në funksion të vlerësimit pozitiv dhe daljes së vendit nga “Lista Gri”, por edhe më gjerë se kaq, duke përçuar në organet përkatëse shqetësimet e sektorit, vlerësimet e tregut, cënueshmëritë dhe pikat e forta të këtij sektori. I gjithë angazhimi ka shkuar dhe shkon në funksion të bashkëpunimit mes aktorëve kyç publik e privat, pa të cilët nuk ka zhvillim dhe arrije të qëndrueshme.

Dalja nga Lista Gri e ndihmon mobilitetin dhe qëndrueshmërinë e tregut të Pasurive të Paluajtshme, duke rritur shpejtësinë e kryerjes së transaksioneve si dhe bërë vendin me tërheqës për investime të huaja cilësore në këtë fushë, gjithnjë në përputhje me legjislacionin parandalues të pastrimit të parave.

Nëpërmjet këtij vlerësimi pozitiv, vijnë dhe incentivat për shëndoshjen e ekonomisë shqiptare nëpërmjet flukseve legjitime në sektorët e Real Estate dhe atë të Turizmit, duke rritur kështu ecurinë drejtë qëndrueshmërisë në këtë trend pozitiv të luftës ndaj pastrimit të parave. Sektori i Pasurive të Paluajtshme, së bashku me sektorë të tjerë, të lidhur mes tyre ngushtësisht, është thelbësor në ekonominë e Shqipërisë dhe do të vazhdojë të jetë promotor zhvillimi.

NAREA është organizata e biznesit të Ndërmjetësuesve të Pasurive të Paluajtshme, një aktor lider në sektorin e pasurive të paluajtshme në Shqipëri, duke qenë e vetmja organizatë e tillë në vend, dhe më e madhja ndër organizimet profesionale dhe ato të sipërmarrjes, me mbi 500 anëtarë, por gjithashtu edhe në rolin e promovuesit të praktikave të biznesit bazuar mbi etikën dhe rregullimin ligjor në fuqi.

NAREA, organizatë me shtrirje kombëtare dhe ndërkombëtare, është anëtare me të drejta të plota të dy organizmave më të rëndësishëm global në sektorin e real estate, e **NAR** (NATIONAL ASSOCIATION OF REALTORS®) me prezencë në Washington DC, USA dhe **CEPI** (Rrjeti Evropian i Profesionistëve të Real Estate) me seli në Bruksel, pranë Komisionit Evropian.


Misioni ynë, është rritja e imazhit të figurës së Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme, në nivele të larta etiko-profesionale dhe në respektim të parashikimeve ligjore, nëpërmjet edukimit dhe fuqizimit të çdo anëtari në **NAREA**.

Duke ju siguruar për vendosmërinë tonë për të vazhduar këtë udhëtim me të njëjtin pasion dhe përkushtim,

Me shumë respekt,

për **NAREA**,

Drejtori Ekzekutiv



Reinaldo Pipiria